



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04  
**Prokurori kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 30 prill 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të të Akuzuarit**  
Zhan-Lui Zhilisen

**Zyrës Administrative**  
Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e  
Dëshmitarëve

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenet 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 95(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Pjetër Shalës (“z. Shala” ose “i akuzuari”).<sup>2</sup>
2. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS-ja”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar,<sup>3</sup> me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>4</sup>
3. Më 16 mars 2021, z. Shala u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”) nga policia belge në praninë e përfaqësuesve të ZPS-së.<sup>5</sup>
4. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.<sup>6</sup>
5. Më 19 prill 2021, z. Shala pati paraqitjen e parë ku u vetëdeklarua i pafajshëm.<sup>7</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetari, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës* (“Vendimi i Konfirmimit”), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00010/A02, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, konfidencial. Një version më pak i redaktuar konfidencial u paraqit në F00016/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit me më pak Redaktime dhe të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave të lidhura me të*, 31 mars 2021, konfidencial.

<sup>4</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 140(c).

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcën 1-2, konfidenciale.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-04, Transkript i Seancës, 19 prill 2021, publik, f. 11, rreshti 11.

6. Më 21 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin për Gjuhën e Punës”, ku vendosi se anglishtja do të ishte gjuha e punës për procesin aktual.<sup>8</sup>

7. Më 23 prill 2021, u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes (“konferenca mbi ecurinë e çështjes”), ku palët bënë parashtrime me gojë dhe me shkrim për probleme të ndryshme që kishin të bënin me nxjerrjen e materialeve, në pritje të këtij vendimi për nxjerrjen e provave.<sup>9</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet përkatëse në posedim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizime rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e garancive mbrojtëse kompensuese të nevojshme.

9. Në përputhje me rregullën 46(1) të Rregullores, dhe në varësi të detyrimeve të Administratorit sipas rregullës 24, ZPS-ja është përgjegjëse për mbajtjen, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit dhe materialit fizik dhe elektronik të mbledhur gjatë hetimeve të veta.

10. Në përputhje me rregullën 95(2)(b) të Rregullores, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit sipas rregullës 92 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

---

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-04, F00025, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Gjuhën e Punës*, (“Vendim për Gjuhën e Punës”), 21 prill 2021, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-04, Transkript, 23 prill 2021 (“Transkript i 23 prillit”), publik. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-04, F00024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime* (“Urdhri për Parashtrime”), 20 prill 2021, publik; F00026, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime në përputhje me Urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datës 20 prill 2021* (“Parashtrimet e Mbrojtjes”), 22 prill 2021, publik; F00027, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 22 prill 2021, publik me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

përcakton afatet për nxjerrjen e provave, merr masa për të mundësuar nxjerrje të provave në kohë, dhe përgatit një raport për trupin gjykues, mbi nxjerrjen e provave.

11. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, ndër të tjera, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; dhe (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

12. Në përputhje me rregullën 102(1)(a) të Rregullores, dhe në varësi të dispozitave të rregullave 105, 106, 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, materialet mbështetëse të aktakuzës së konfirmuar, si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit, sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën brenda tridhjetë (30) ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit.

13. Në pajtim me rregullën 102(1)(b) të Rregullores, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes materialin në vijim: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë të dëshmojnë në gjykim në gjuhën që kupton dhe flet i akuzuari; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet, ose transkriptet të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) të gjitha provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

14. Në pajtim me rregullat 102(2) dhe (4) të Rregullores, ato deklarata të dëshmitarëve shtesë të ZPS-së, të cilat nuk janë nxjerrë brenda afatit prej 30 ditësh para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë të dëshmojnë në gjykim, i vihen në dispozicion Mbrojtjes sa më shpejt që të jetë e mundshme, në

gjuhën që kupton dhe flet i akuzuari, dhe së bashku me arsyetimin për vonesën në nxjerrjen e tyre. Nxjerrja e materialeve të tilla përfundohet gjatë fazës së procedurës paraprake.

15. Në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja vë në dispozicion të Mbrojtjes, pas kërkesës dhe pa vonesë, çdo deklaratë, dokument dhe fotografi dhe lejon këqyrjen e sendeve tjera të prekshme nën ruajtjen apo kontrollin e ZPS-së, të cilat Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit.

16. Në pajtim me rregullën 103 të Rregullores, dhe në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja vë menjëherë në dispozicion të Mbrojtjes çdo informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit apo të ndikon në besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e provave të ZPS-së, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së.

17. Në bazë të nenit 23(1) të Ligjit, rregullave 80(1) dhe 108(1)(b) të Rregullores, një panel mund të urdhërojë, *proprio motu* ose në bazë të një kërkesë, masa të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dëshmitarëve.

18. Në përputhje me rregullën 80(4)(a)(i)-(iii), (d), dhe (e) të Rregullores, ndër masa të tilla mund të përfshihen fshirja e emrave dhe të dhënave identifikuese të tjera për të parandaluar nëse është e domosdoshme, nxjerrjen për të akuzuarit dhe/ose publikun, të identitetit dhe/ose vendndodhjes së një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në proces gjyqësor, ose të një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër me ta.

19. Në përputhje me rregullën 107(2) të Rregullores, ZPS-ja i bën panelit kërkesë për t'u liruar, tërësisht ose pjesërisht, nga detyrimi sipas rregullës 102 dhe rregullës 103 për nxjerrjen e materialit fillestar nëse informacioni, të cilin e ka nën ruajtje ose

kontroll, i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja dhe për të cilin nuk e ka pëlqimin e dhënësit të informacionit për ta nxjerrë.

20. Në përputhje me rregullën 108(1)(a) dhe (c) të Rregullores, ZPS-ja mund të kërkojë nga paneli që të mos nxjerrë informacionin, tërësisht ose pjesërisht, kur nxjerrja e këtij informacioni mund të cenojë hetimet aktuale, ose hetimet e ardhshme ose të jetë në kundërshtim, për ndonjë arsye tjetër, me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta. Në përputhje me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

21. Në përputhje me rregullën 109(b) dhe (c) të Rregullores, edhe ZPS-ja edhe Mbrojtja, nëse vendosin të nxjerrin ndonjë informacion, kur nxjerrin informacion, paraqesin: (i) një përshkrim të qartë dhe të përmbledhur të dokumenteve, ose kategorive të dokumenteve, që i janë nxjerrë palës tjetër; (ii) një kategorizim të informacionit të nxjerrë në përputhje me akuzat e Aktakuzës së Konfirmuar, duke iu referuar veprave penale konkrete që përbëjnë bazën e tyre, elementeve kontekstuale të veprave penale, veprimeve të pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provave që do të paraqiten nga ZPS-ja.

22. Në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që të dorëzojë, brenda një afati të përcaktuar, dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve që ZPS-ja synon të thërrasë gjatë gjykimit dhe listën e propozuar të provave materiale që synon të paraqesë gjatë gjykimit.

23. Në përputhje me rregullën 95(5) të Rregullores, pas paraqitjes së dosjes paraprake dhe listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të propozuara nga ZPS-ja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjet përkatëse paraprake që përmbajnë: (i) një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së mbrojtjes së të akuzuarit; (ii) akuzat dhe pikat që i akuzuari kundërshton, duke iu referuar paragrafëve konkretë në dosjen paraprake të ZPS-së dhe arsyet e kundërshtimit të tyre nga i akuzuari; (iii) listën e dëshmitarëve të mundshëm që ata

synojnë t'i thërrasin, si edhe me cilin aspekt përkatës të provave kanë të bëjnë, e cila nuk paragjykon ndryshime të mëvonshme të listës ose paraqitjen e këtyre ndryshimeve. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu kërkon nga Mbrojtja, që brenda një afati të përcaktuar, ta njoftojë ZPS-në dhe trupin gjykues mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale.

24. Në përputhje me rregullën 104(5) të Rregullores, brenda afatit të caktuar nga paneli dhe jo më vonë se 15 ditë përpara hapjes së çështjes, Mbrojtja: (i) e lejon ZPS-në që të këqyrë dhe të bëjë kopje të çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Mbrojtjes, të cilat Mbrojtja synon t'i përdorë si prova në gjykim; (ii) i jep ZPS-së të gjitha deklaratat, nëse ka, të të gjithë dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim ose synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) i jep ZPS-së të gjitha provat materiale që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim.

25. Në përputhje me rregullat 106, 107(1) dhe 111(1) të Rregullores, kategori të caktuara të materialit, në parim, nuk janë objekt i nxjerrjes së materialit, në varësi të Rregullores dhe përveçse kur paneli urdhëron ndryshe. Këto përfshijnë: (i) raportet, memorandumet, ose dokumentet e tjera të brendshme të përgatitura nga ZPS-ja (përshirë Task Forcën Hetimore Speciale), Mbrojtja dhe mbrojtësit e viktimave, përfshirë ndihmësit dhe përfaqësuesit e tyre (rregulla 106 e Rregullores); (ii) materialin që i është dhënë ZPS-së në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja (rregulla 107(1) e Rregullores); dhe (iii) komunikimet e privileguara përkufizuar në rregullën 111(1) të Rregullores.

### III. PARASHTRIMET E PALËVE

26. ZPS-ja parashtron se një numër i vogël hapash hetimorë janë në vazhdimësi dhe në varësi të rezultatit të këtyre hetimeve, ka gjasa që të paraqiten prova të mëtejshme,

pa ndikim mbi kryerjen e shpejtë të procesit.<sup>10</sup>ZPS-ja gjithashtu parashtron se ka paraqitur material mbështetës dhe do të jetë në gjendje të nxjerrë të gjithë materialet mbështetëse të aktakuzës, në përputhje me rregullën 102(1)(a) të Rregullores, duke përfshirë përkthimet e tyre, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.<sup>11</sup> ZPS-ja më tej parashtron se do të jetë në gjendje të plotësojë detyrimet e nxjerrjes së informacionit sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores deri më 30 korrik 2021<sup>12</sup> dhe do t'i japë Mbrojtjes njoftim të hollësishëm të materialit të provave, në përputhje me rregullën 102(3) të Rregullores, deri më 3 shtator 2021.<sup>13</sup> ZPS-ja nxori prova shfajësuese, sipas rregullës 103 të Rregullores, më 22 prill 2021, dhe deklaroi se do të vazhdojë ta bëjë një gjë të tillë në vijimësi.<sup>14</sup> ZPS-ja parashtron se një sasi e kufizuar e materialit të rregullës 107 është objekt i nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102 ose 103 të Rregullores dhe për këtë arsye nuk parashikohet të ketë ndikim mbi afatet e propozuara.<sup>15</sup> Në lidhje me materialet që nuk janë objekt i nxjerrjes, ZPS-ja parashtron se disa nga provat sipas rregullës 102(1)(a) dhe (b), 102(3), 103, dhe 107 të Rregullores mund të kenë nevojë për redaktime<sup>16</sup> dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të zbatojë sistemin e redaktimit të çështjes *Gucati dhe Haradinaj*.<sup>17</sup> Në lidhje me procedurën e nxjerrjes së materialeve, sipas rregullës 109 të Rregullores, ZPS-ja parashtron se kategorizimi specifik i materialeve për çështjen në sistemin elektronik *Legal Workflow* do të ishte një proces që do të merrte shumë kohë dhe do të kishte dobi

---

<sup>10</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3; Transkript i 23 prillit, f. 19, rreshtat 19-22.

<sup>11</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para 7-8; Transkript i 23 prillit, f. 24, rreshti 22 deri në f. 25, rreshti 18.

<sup>12</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 9; Transkript i 23 prillit, f. 27, rreshti 11 deri në f. 28, rreshti 4.

<sup>13</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 15; Transkript i 23 prillit, f. 29, rreshti 25 deri në f. 30, rreshti 16, f. 31, rreshtat 19-22.

<sup>14</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para 18, 20; Transkript i 23 prillit, f. 32, rreshti 15 deri në f. 33, rreshti 8.

<sup>15</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para 22-23; Transkript i 23 prillit, p. 34, rreshtat 7-17.

<sup>16</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para 8, 12, 17, 21, 25.

<sup>17</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 30; Transkript i 23 prillit, f. 39, rreshtat 7-8.



të kufizuar për të akuzuarin.<sup>18</sup> ZPS-ja më tej propozon se tabela përmbledhëse sipas rregullës 109(c) duhet të paraqitet brenda 15 ditësh nga dorëzimi i dosjes paraprake.<sup>19</sup>

27. Z. Shala parashtron se ai nuk është në gjendje në këtë fazë të hershme të japë një përlllogaritje të kohës së duhur për hetimet e nevojshme për prezantimin e çështjes së tij.<sup>20</sup> Gjithashtu, ai nuk është në gjendje të tregojë nëse më vonë do të njoftohet alibia dhe/ose arsye të tjera për përjashtimin e përgjegjësisë penale.<sup>21</sup> Në lidhje me materialin sipas rregullës 102(1)(a), z. Shala kërkon që ky material të nxirret sa më shpejt të jetë e mundur dhe të paktën 30 ditë që nga paraqitja e parë.<sup>22</sup> Z. Shala argumenton se materiali sipas rregullës 102(1)(b) duhet të nxirret sa më shpejt që të jetë e mundur dhe se do të ishte plotësisht e pamjaftueshme nxjerrja e një materiali të tillë 30 ditë para hapjes së çështjes nga Prokuroria.<sup>23</sup> Në lidhje me nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(3) dhe 103 të Rregullores, z. Shala parashtron se ky material duhet të nxirret menjëherë ose në çdo rast, deri më 22 maj 2021.<sup>24</sup> Z. Shala paraprakisht bie dakort me sistemin e nxjerrjes dhe redaktimit të materialeve, të zbatuar në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*.<sup>25</sup> Në lidhje me procedurën e nxjerrjes së materialeve, sipas rregullës 109 të Rregullores, z. Shala mbështet kategorizimin specifik për çështjen në sistemin elektronik *Legal Workflow* dhe propozon nënkategoritë e mëposhtme shtesë: (i) “elementet kontekstuale: informacion bazë” dhe (ii) “vendndodhja: tjetër”.<sup>26</sup> Z. Shala propozon që tabela sipas rregullës 109(c) të vihet në dispozicion shumë kohë përpara dosjes paraprake të ZPS-së.<sup>27</sup>

<sup>18</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para 26-28; Transkript i 23 prillit, f. 35, rreshti 24 deri në f. 37, rreshti 5; f. 38, rreshtat 14-18.

<sup>19</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 29; Transkript i 23 prillit, f. 39, rreshti 22 deri në f. 40, rreshti 10.

<sup>20</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5; Transkript i 23 prillit, f. 21, rreshtat 6-9.

<sup>21</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 6; Transkript i 23 prillit, f. 21, rreshtat 10-14.

<sup>22</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 11.

<sup>23</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 12.

<sup>24</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 13.

<sup>25</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para 10, 14; Transkript i 23 prillit, f. 39, 12-16.

<sup>26</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, paras 7-8; Transkript i 23 prillit, f. 37, rreshtat 22 deri në f. 38, rreshti 9.

<sup>27</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 9; Transkript i 23 prillit, f. 21, rreshtat 15-20.

## IV. DISKUTIM

### A. PARIMET PËR NXJERRJEN E PROVAVE

#### 1. Hyrje

28. Korniza ligjore e DHS-së parasheh disa hapa proceduralë që duhet të ndërmerren nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, palët dhe mbrojtësi i viktimave, kur është e zbatueshme, në periudhën ndërmjet paraqitjes së parë të të akuzuarit dhe dorëzimit të dosjes së çështjes Trupit Gjykues, në pajtim me rregullën 98 të Rregullores. Ndër hapat kritikë, është përcaktimi i një sistemi për shkëmbimin e provave midis palëve dhe vënia në dijeni e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Miratimi i një sistemi që mundëson efikasitetin e procesit të nxjerrjes së informacionit është themelor për Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të arrijë baraspeshimin midis detyrës së tij për të mbrojtur interesa të caktuara, përfshirë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse dhe personave të tjerë të rrezikuar dhe detyrimit për të mbështetur të drejtat e të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit.<sup>28</sup>

#### 2. Roli i palëve dhe Zyrës Administrative

29. Nxjerrja e provave, dhe detyrimet që dalin për palët sipas Rregullores, është proces që ndodh midis ZPS-së dhe Mbrojtjes. Ky proces duhet të organizohet dhe ndihmohet nga Zyra Administrative, që vepron si kanal komunikimi midis palëve dhe panelit,<sup>29</sup> përmes programit elektronik që është siguruar për këtë qëllim, siç është

---

<sup>28</sup> Urdhri për Parashtrime, para. 20. Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-117-Red3, Pre-Trial Chamber II, [Redacted First Decision on the Prosecutor's Request for Redactions and Related Requests](#), 3 July 2014, para. 17, dhe referencat që përmban.

<sup>29</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-31-tENG, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Evidence Disclosure Protocol and Other Related Matters](#) ("Al Hassan Disclosure Decision"), 16 May 2018, para. 36; *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-203, Pre-Trial Chamber II, [Decision Setting the Regime for Evidence Disclosure and Other Related Matters](#) ("Ongwen Disclosure Decision"), 27 February 2015, para. 10.

përcaktuar në rregullat 98(1)(b) dhe 109(a) të Rregullores. Palët i përmbahen Udhëzimit të Zyrës Administrative për ngarkimin e të dhënave në sistemin elektronik *Legal WorkFlow* gjatë nxjerrjes së provave në mënyrë elektronike.<sup>30</sup>

30. Në pajtim me nenin 34(1) të Ligjit dhe rregullën 24(1) dhe (2) të Rregullores, Administratori administron dokumentimin e plotë dhe të saktë të proceseve gjyqësore dhe ruan të gjitha provat dhe materialet e tjera të paraqitura gjatë proceseve gjyqësore, në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë vendim dhe vendimet e ardhshme për këtë çështje. Ky dokumentacion duhet të jetë në dispozicion të palëve dhe pjesëmarrësve, sipas rastit, objekt i kufizimeve të domosdoshme në lidhje me mbrojtjen dhe nivelin e konfidencialitetit, siç parashihet në nenet 23 dhe 58 të Ligjit, si dhe rregullat 80, 82, 105, 106, 107 dhe 108 të Rregullores, ose sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Në lidhje me këtë aspekt, kur nxjerrin prova, palët përcaktojnë nivelin e përshtatshëm të klasifikimit për secilën provë dhe i regjistrojnë provat si publike, përveçse kur ka arsye që t'i klasifikojnë ndryshe, në pajtim me rregullën 83(1) të Rregullores.<sup>31</sup>

### **3. Komunikimi i provave Gjykatësit të Procedurës Paraprake**

31. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ai ka detyrën të marrë të gjitha masat për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim, siç kërkohet nga nenet 39(1) dhe (13) të Ligjit dhe rregullës 95(2) të Rregullores, duke përfshirë një raport të nxjerrjes së materialeve për trupin gjykues, siç parashikohet në rregullën 95(2)(b) të Rregullores. Në mënyrë që të përmbushet kjo detyrë, të gjitha provat e shkëmbyera mes palëve i komunikohen Gjykatësit të Procedurës Paraprake, pavarësisht nëse ato do të përdoren

---

<sup>30</sup> KSC-BD-18, Administratorja, Udhëzim për Ngarkimin e Të Dhënave në Sistemin Elektronik *Legal Workflow*, 28 gusht 2019.

<sup>31</sup> Shih, në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-64-Red, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of "Decision on Disclosure and Related Matters"](#), ("Yekatom Disclosure Decision") 23 January 2019, para. 17.

në gjykim. Ky komunikim ndihmon Gjykatësin e Procedurës Paraprake të sigurohet se nxjerrja e provave kryhet në pajtim me kushtet e përcaktuara.<sup>32</sup>

32. Për rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të ketë qasje në këto prova të nxjerra: (a) të gjitha provat në të cilat mbështetet ZPS-ja për të mbështetur Aktakuzën e Konfirmuar; (b) të gjitha deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim (rregullat 102(1)(b)(i) të Rregullores); (c) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet apo transkriptet që Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 102(1)(b)(ii) të Rregullores); (d) të gjitha provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 102(1)(b)(iii) të Rregullores); (e) të gjitha provat që vlerësohen nga Mbrojtja si juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit (rregulla 102(3) të Rregullores); (f) të gjitha provat shfajësuese që ZPS-ja i ruan, kontrollon ose ka dijeni për to, (rregulla 103 e Rregullores); (g) të gjitha provat që Mbrojtja mund t'i paraqesë për të vërtetuar një alibi ose arsye që përjashton përgjegjësinë penale, përfshirë emrat dhe të dhënat aktuale të dëshmitarëve, dhe çfarëdo prove tjetër në të cilën i akuzuari synon të mbështetet për të vërtetuar këtë alibi ose arsye (rregulla 104(1)(a) dhe (b) të Rregullores); (h) të gjitha provat që Mbrojtja i ka në ruajtje ose nën kontroll, që mund të këqyren nga ZPS-ja dhe Mbrojtja synon t'i përdorë në gjykim (rregullat 104(5)(a) të Rregullores); (i) të gjitha deklaratat, nëse ka, të dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim ose synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 104(5)(b) të Rregullores); dhe (j) të gjitha provat materiale që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim (rregulla 104(5)(c) të Rregullores).

---

<sup>32</sup> Shih, në mënyrë të ngjashme, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 12; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 14.

#### 4. Afatet për nxjerrjen e materialeve

33. Sipas kuadrit ligjor të DHS-së, nxjerrja e disa kategorive të materialeve është objekt i afateve të përcaktuara në Rregullore, ndërsa për kategoritë e tjera të materialit, përcaktimi i afateve të përshtatshme për nxjerrje të materialit i lihet Gjykatësit të Procedurës Paraprake, duke pasur parasysh veçantitë e çështjes, vëllimit dhe llojit të provave shkresore dhe parashtrimet e palëve.

34. Megjithëse vendimi aktual përcakton kalendarin për nxjerrjen e provave të kategorive të ndryshme, këto afate sugjerojnë vetëm afatin minimal për dhënien e njoftimit. Kur është e mundshme, pala që bën nxjerrjen e materialit, duhet të përpiqet të nxjerrë materialin përpara afateve të përcaktuara për të lejuar përgatitjen e mirëfilltë nga pala që merr materialin.<sup>33</sup> Nxjerrja e materialeve pas afateve të përcaktuara në këtë vendim ose sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake do t'i njoftohen Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe palës që merr materialin, së bashku me arsyet për vonesën e nxjerrjes së materialeve.

#### 5. Plotësia dhe rëndësia e provave të nxjerra

35. Secila palë mundëson që provat e nxjerra të jenë të plota. Provat që janë nxjerrë padashur në formë jo të plotë mund të nxirren përsëri brenda afatit që parashihet në Rregullore, ose sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

36. Palët gjithashtu mundësojnë që paketat e materialeve të nxjerra të jenë të plota dhe **të lidhura në mënyrën e duhur** me dëshmitarin(ët) përkatës. Në këtë aspekt, të gjitha dokumentet dhe materialet e përmendura në një deklaratë të një dëshmitari konkret, nxirren së bashku me deklaratën përkatëse, në të njëjtën paketë materialesh. Gjithashtu, kur provat kanë lidhje me një dëshmitar konkret, kjo lidhje do të

---

<sup>33</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 13; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para 20-21.

përcaktohet duke përfshirë pseudonimin e dëshmitarit në fushën e meta të dhënave për secilën provë përkatëse në sistemin elektronik *Legal Workflow*.

37. ZPS-ja dhe Mbrojtja, nëse dëshiron, nxjerrin vetëm provat me rëndësi të mirëfilltë që mbështesin pretendimet në lidhje me fakte konkrete që plotësojnë kriteret ligjore të nevojshme, e jo sa më shumë prova, për të lejuar palën që merr provat që të përqendrohet në përgatitjet e veta.<sup>34</sup>

## B. AFATET PËR NXJERRJEN E PROVAVE

### 1. Rregulla 102(1)(a): Materialet mbështetëse të Aktakuzës

38. Rregulla 102(1)(a) e Rregullores trajton nxjerrjen e materialit në të cilin mbështetet ZPS-ja për të argumentuar Aktakuzën e Konfirmuar, përfshirë deklaratat e marra nga të akuzuarit. Ky material duhet të nxirret sa më parë që është e mundur, po së paku brenda 30 ditësh pas paraqitjes së parë të të akuzuarit.

39. Në këtë çështje, më 22 prill 2021, ZPS-ja nxori një pjesë të materialit mbështetës të aktakuzës që nuk ka lidhje me dëshmitarët<sup>35</sup> dhe Mbrojtja konfirmoi marrjen e tij.<sup>36</sup> Si ZPS-ja ashtu edhe Mbrojtja janë të mendimit se pjesa e mbetur e materialit sipas rregullës 102(1)(a) duhet të nxirret brenda afatit 30ditor.<sup>37</sup> Gjithsesi, ZPS-ja shton se përmbushja e këtij afati varet nga trajtimi i kërkesave për masa mbrojtëse.<sup>38</sup> Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon të përshtatshëm të caktojë të mërkurën, 19 maj 2021, si afatin për të plotësuar nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(a).

<sup>34</sup> Transkript i 23 prillit, f. 19, rreshtat 6-8. Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 18; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 25; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 20.

<sup>35</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 7; Transkript i 23 prillit, f. 24, rreshti 22 deri te f. 25, rreshti 4.

<sup>36</sup> Transkript i 23 prillit, f. 26, rreshtat 5-6.

<sup>37</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 8; Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 11; Transkript i 23 prillit, f. 24, rreshtat 11-13.

<sup>38</sup> Transkript i 23 prillit, f. 25, rreshtat 9-18.

40. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja ka dorëzuar një përmbledhje të detajuar të materialit mbështetës, siç përcaktohet nga rregulla 86(3)(b) të Rregullores (“përmbledhja e detajuar”).<sup>39</sup>Në mënyrë që të mundësojë qasjen e të akuzuarit në versionet e ndryshme të këtij dokumenti dhe të respektojë parimin e procesit publik, ZPS-ja do të dorëzojë një version konfidencial (të redaktuar) dhe një publik (të redaktuar) të përmbledhjes së detajuar pas plotësimit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(1)(a) të mërkurën më 19 maj 2021.

## **2. Rregulla 102(1)(b): Materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim**

41. Rregulla 102(1)(b) e Rregullores trajton nxjerrjen e çfarëdo materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim, të cilin ZPS-ja nuk e ka përdorur si material mbështetës për aktakuzën që ka paraqitur për konfirmim. Ky material duhet të nxirret brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe sido që të jetë, jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga ZPS-ja, në përputhje me rregullën 124 të Rregullores.

42. Afati për nxjerrjen e një materiali të tillë mund të varet nga faktorë si: (i) sasia dhe lloji i materialit që do të nxirret; (ii) kur është mbledhur materiali nga ZPS-ja; (iii) nevoja për të kryer veprime hetimore (duke përfshirë edhe marrjen e lejeve të domosdoshme nga dhënësit e informacionit) para nxjerrjes së këtij materiali; (iv) nevoja për të përkthyer këtë material ose pjesë të tij, sidomos deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar; dhe (v) nevoja për të zbatuar masa mbrojtëse, përfshirë redaktimin e informacionit.

---

<sup>39</sup> KSC-BC-2020-04, F00002/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesa në lidhje me Të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i përditësuar u dorëzua më 18 mars 2020. F00004/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesa në lidhje me Të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

43. Nëse ZPS-ja dëshiron të nxjerrë deklarata shitesë të dëshmitarëve që synon t'i thërrasë të dëshmojnë në gjykim, por nuk e ka bërë një gjë të tillë gjatë afatit të caktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, kjo nxjerrje e vonuar duhet të plotësojë kriteret e rregullës 102(1), (2), dhe (4) të Rregullores, përfshirë përkthimin. Mbrojtja mund t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake kur ka arsye për mospajtim për nxjerrjen e vonuar të materialeve.

44. ZPS-ja parashtron se me gjasë materiali sipas rregullës 102(1)(b) do të përfshijë deklarata të rreth tetë dëshmitarëve dhe 54 prova materiale për gjykim, si material audio/video, aktekspertiza, fotografi dhe publikime nga burime të hapura.<sup>40</sup> Ajo konfirmon se është e gatshme ta nxjerrë këtë material në vijimësi deri në afatin përfundimtar më 30 korrik 2021, ose jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes.<sup>41</sup> Sidoqoftë, përlllogaritjet e ZPS-së në lidhje me sasinë dhe llojin e materialit sipas rregullës 102(1)(b) varen nga rezultati i hapave hetimorë të papërfunduar dhe të kufizuar.<sup>42</sup> Transkriptimi dhe përkthimi i deklaratave të dëshmitarëve është një proces në vazhdimësi i cili nuk duhet të ketë ndikim mbi afatet.<sup>43</sup> ZPS-ja parashtron se do të jetë e nevojshme të redaktojë materialet e ardhshme të nxjerra sipas rregullës 102(1)(b) dhe për pasojë, ZPS-ja parashikon paraqitjen e një kërkesë të dytë për masa mbrojtëse më 11 qershor 2021.<sup>44</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron se do të bëjë përpjekje të nxjerrë të gjitha materialet dhe dokumentet e përmendura në deklaratat e dëshmitarëve së bashku me deklaratat përkatëse.<sup>45</sup> Mbrojtja kërkon që nxjerrja e materialeve sipas kësaj rregulle të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe se afati 30-ditor para gjykimit do të ishte plotësisht i pamjaftueshëm.<sup>46</sup>

---

<sup>40</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para 10-11; Transkript i 23 prillit, f. 27, rreshtat 15-18.

<sup>41</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 9; Transkript i 23 prillit, f. 27, rreshtat 11-14, f. 28, rreshtat 23-24.

<sup>42</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

<sup>43</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 10; Transkript i 23 prillit, f. 27, rreshtat 19-23.

<sup>44</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 12; Transkript i 23 prillit, f. 27, rreshti 24 to f. 25, rreshti 4.

<sup>45</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

<sup>46</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 12.



45. Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve për afatin e propozuar për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron të përshtatshme të caktojë të premtën 30 korrik 2021 si afat për nxjerrjen e materialeve sipas kësaj rregulle. Për të plotësuar detyrimet e veta për nxjerrjen e materialeve, ZPS-ja do të nxjerrë të gjitha dokumentet dhe materialet e përmendura në deklaratat e dëshmitarëve së bashku me deklaratat përkatëse në të njëjtën paketë të nxjerrjes së materialeve, siç u diskutua në paragrafin 36 më lart. Për sa u përket kërkesave për masat mbrojtëse, ZPS-ja do të paraqesë çdo kërkesë të tillë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se deri të premtën, 11 qershor 2021, në mënyrë që të japë kohën e nevojshme për zbatimin e redaktimeve dhe për të njohur Mbrojtjen me materialin brenda afatit të caktuar.

### **3. Rregulla 102(3): Provat juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të marra nga i akuzuari ose që i përkasin atij**

46. Materiali i rregullës 102(3) përfshin provat që konsiderohen juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të cilat i ka ZPS-ja në ruajtje ose kontroll, ose që i janë marrë apo i kanë përkatur të akuzuarit, përfshirë dokumente, fotografi dhe sende të tjera të prekshme.

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se rregulla 102(3) e Rregullores parashikon një procedurë që përfshin hapat në vijim: (i) dhënia e njoftimit të hollësishëm Mbrojtjes nga ana e ZPS-së për çdo material dhe provë që ka në zotërim; (ii) kërkesat nga Mbrojtja për nxjerrjen ose këqyrjen e materialit në ruajtje ose kontroll të ZPS-së që konsiderohen juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, të marra nga i akuzuari ose që i përkasin atij; dhe (iii) kundërshtime të ngritura nga ZPS-ja në lidhje me rëndësinë juridikisht thelbësore të materialit të kërkuar nga Mbrojtja.

48. Si hap i parë, ZPS-ja do të përgatisë dhe nxjerrë një njoftim të detajuar të të gjithë materialit dhe provave në zotërim të saj pa vonesë, siç parashikohet në rregullën

102(3) të Rregullores. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo kërkesë ka të bëjë me çdo provë dhe material në zotërim të ZPS-së. Njoftimi i detajuar duhet të përfshijë jo vetëm informacion që ZPS-ja vlerëson potencialisht të rëndësishëm për përgatitjen e Mbrojtjes, por edhe çdo material dhe provë në zotërim të ZPS-së që nuk është nxjerrë sipas rregullave 102(1)(a)-(b) dhe 103 të Rregullores dhe që kanë lidhje me çështjen.

49. Siç është përcaktuar shprehimisht në rregullën 102(3) të Rregullores, argumentet për rëndësinë materiale të provave materiale të tilla bëhen nga Mbrojtja. Shprehja *juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes* interpretohet gjerësisht dhe u referohet të gjitha dokumenteve dhe objekteve që janë relevante për përgatitjen e çështjes nga Mbrojtja, në ushtrim të të drejtave të të akuzuarit sipas Ligjit dhe Rregullores.<sup>47</sup> Çfarë është *relevante* në këtë aspekt nuk duhet detyrimisht të kufizohet nga kuadri kohor që mbulon Aktakuza e Konfirmuar e as nuk duhet të kufizohet vetëm në materialin relevant për kundërshtimin e provave të ZPS-së.<sup>48</sup> *Përgatitja e Mbrojtjes* është gjithashtu koncept i gjerë dhe nuk duhet të kufizohet vetëm në çfarë ka lidhje të drejtpërdrejtë me provat inkriminuese ose shfajësuese,<sup>49</sup> ose të lidhur me provat e paraqitura nga ZPS-ja.<sup>50</sup>

50. Mbrojtja mund të kërkojë nxjerrjen ose këqyrjen e materialit që nuk është përfshirë në njoftimin e ZPS-së por që Mbrojtja pretendon se ka rëndësi materiale për përgatitjen e saj. Në një rast të tillë gjithsesi, Mbrojtja duhet të (i) japë parametra të përshtatshëm

---

<sup>47</sup> Transkript i 23 prillit, f. 29, rreshtat 4-11. Në mënyrë të ngjashme, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/AC/AR126.4, F0004, Appeals Chamber, [Public Redacted Version of 19 September Decision on Appeal by Counsel for Mr Oneissi Against Pre-Trial Judge's "Decision on Issues Related to the Inspection Room and Call Data Records"](#), ("2 October 2013 Decision") 2 Ovtobër 2013, para. 21, dhe referencat që përmban; ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1433 (OA 11), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr. Lubanga Dyilo against the Oral Decision of Trial Chamber I of 18 January 2008](#), ("11 July 2008 Judgment") 11 July 2008, para 77-78; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-1330 (OA 3), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Bosco Ntaganda against the "Decision on Defence requests seeking disclosure orders and a declaration of Prosecution obligation to record contacts with witnesses"](#), 20 May 2016, para. 23, dhe referencat që përmban.

<sup>48</sup> Në mënyrë të ngjashme, STL, [2 October 2013 Decision](#), para. 22, dhe referencat që përmban.

<sup>49</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [11 July 2008 Judgment](#), para. 77.

<sup>50</sup> Në mënyrë të ngjashme, STL, [2 October 2013 Decision](#), para. 22, dhe referencat që përmban.

për specifikimin e çdo dokumenti të kërkuar, për t'i mundësuar ZPS-së që të identifikojë dokumentin e kërkuar; dhe (ii) të sqarojë rëndësinë materiale të dokumenteve të kërkuara për përgatitjen e Mbrojtjes. Mbrojtja nuk mund të përdorë përshkrime të përgjithshme ose pretendime pa baza për informacionin e kërkuar dhe duhet të evitohet paraqitjen e kërkesave në formën e frazave gjithëpërfshirëse.

51. Së fundmi, ZPS-ja mund t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake kur ka arsye për të kundërshtuar rëndësinë materiale që i jep Mbrojtja informacionit. Nëse ZPS-ja nuk pajtohet me këto kërkesa të Mbrojtjes, ajo mund të kundërshtojë parametrat e specifikimit si dhe rëndësinë materiale të dokumenteve të kërkuara.

52. ZPS-ja parashtron se do të jetë në gjendje të nxjerrë njoftim të hollësishëm për materialin sipas rregullës 102(3) të premtën, 3 shtator 2021, pak pas përfundimit të nxjerrjes së materialit të rregullës 102(1)(b).<sup>51</sup> Ky njoftim i hollësishëm do të përfshijë çdo informacion tjetër potencialisht të rëndësishëm për Mbrojtjen pasi të jenë nxjerrë materialet që do të prezantohen në gjykim dhe provat shfajësuese.<sup>52</sup> Bazuar në shqyrtimin në vazhdimësi, ZPS-ja parashikon që numri i gjithsejtë i dokumenteve sipas rregullës 102(3), të jetë më pak se 3.000.<sup>53</sup> Disa prej materialeve mund të kenë nevojë për redaktime, në veçanti në lidhje me rregullën 108(1) të Rregullores.<sup>54</sup> Mbrojtja kërkon që nxjerrja e materialit sipas kësaj rregulle të bëhet menjëherë ose sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast deri më 22 maj 2021.<sup>55</sup> Gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, Mbrojtja bëri me dije se ishte e gatshme për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(3) pas nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(1)(a) dhe (b).<sup>56</sup>

53. Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të përshtatshme të caktojë të premtën, 3 shtator 2021, si afat për nxjerrjen

---

<sup>51</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 15; Transkript i 23 prillit, f. 30, rreshtat 4-16, f. 31, rreshtat 19-22.

<sup>52</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 15.

<sup>53</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 16; Transkript i 23 prillit, f. 30, rreshtat 1-3.

<sup>54</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 17.

<sup>55</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 13.

<sup>56</sup> Transkript i 23 prillit, f. 31, rreshtat 4-10.

e njoftimit të detajuar për provat sipas rregullës 102(3) të Rregullores. Më pas, Mbrojtja do t'i bëjë me dije ZPS-së se në cilët nga dokumentet e renditura në njoftimin e hollësishëm kërkon të ketë qasje, në formën e nxjerrjes së materialeve ose me këqyrje. Mbrojtja do të njoftojë për këtë deri të premten, 17 shtator 2021 ose më herët. Në bazë të këtij njoftimi, ZPS-ja do të nxjerrë informacion ose do të japë qasje për materialin e përzgjedhur që nuk ka nevojë për redaktim jo më vonë se të premten 24 shtator 2021, ose brenda një jave që nga njoftimi i Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme. Nëse Mbrojtja do të kërkojë qasje në material dhe nxjerrje të materialit sipas rregullës 102(3) që kërkon redaktim, ZPS-ja do t'i bëjë Gjykatësit të Procedurës Paraprake një kërkesë të menjëhershme për masa mbrojtëse, jo më vonë se të premten, 1 tetor 2021, ose brenda dy javësh nga njoftimi i Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme. Nëse ZPS-ja dëshiron të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave të njoftuara nga Mbrojtja, do t'i drejtohet panelit brenda pesë ditësh që nga njoftimi i Mbrojtjes.

#### **4. Rregulla 103: Provat shfajësuese**

54. Materiali i rregullës 103 (provat shfajësuese) përfshin çfarëdo informacioni që është nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së, për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të ZPS-së. Kushti që ZPS-ja t'i nxjerrë provat shfajësuese *menjëherë, sapo* të jenë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të saj, vë në dukje detyrimin e përhershëm të ZPS-së që t'i japë një material të tillë Mbrojtjes, përveçse kur arsye për ligjëse parandalojnë nxjerrjen e menjëhershme të

informacionit.<sup>57</sup> I takon ZPS-së që të bëjë vlerësimin fillestar nëse një informacion i caktuar është ose nuk është shfajësues dhe duhet të bëhet me ndershmëri.<sup>58</sup>

55. Më 22 prill 2021, ZPS-ja nxori 15 prova mundësisht shfajësuese, duke përfshirë një deklaratë dëshmitari dhe pesë deklarata të të akuzuarit.<sup>59</sup> Duke pasur parasysh detyrimin e saj në vijimësi sipas kësaj rregulle, ZPS-ja parashtron se do të vazhdojë të rishikojë dhe menjëherë të nxjerrë në vijimësi materialet në zotërim të saj sipas rregullës 103, duke kryer redaktimet e nevojshme.<sup>60</sup> ZPS-ja parashikon se disa materiale sipas rregullës 103 mund të kenë nevojë për redaktime, në veçanti në përputhje me rregullën 108(1).<sup>61</sup> Mbrojtja kërkon që materiali sipas rregullës 103 të nxirret menjëherë ose sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast deri më 22 maj 2021.<sup>62</sup>

56. Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të arsyeshme të urdhërojë ZPS-në që të nxjerrë çdo paketë materialesh sipas rregullës 103 sa më shpejt që të jetë e realizueshme dhe në vijimësi, veçanërisht nëse materiali nuk kërkon redaktime. Nëse paketat e ardhshme të materialit mundësisht shfajësues do të kenë nevojë për redaktime, ZPS-ja do t'i drejtohet fillimisht panelit në mundësinë më të parë për të marrë vendim për problemin, në mënyrë që të lehtësojë nxjerrjen e menjëhershme të këtij materiali Mbrojtjes.

---

<sup>57</sup> Transkript i 23 prillit, f. 32, rreshtat 1-8. Në mënyrë të ngjashme, ICTR, *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Decision on Motions Relating to the Appellant Hassan Ngeze's and the Prosecution's Request for Leave to Present Additional Evidence of Witness ABC1 and EB](#) ("27 November 2006 Decision"), 27 nëntor 2006, para. 11, dhe referencat që përmban. Shih gjithashtu, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 16; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 18.

<sup>58</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICTR, [27 November 2006 Decision](#), para. 11, dhe referencat që përmban.

<sup>59</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 19; Transkript i 23 prillit, f. 32, rreshtat 19 deri f. 33, rreshtat 1-2.

<sup>60</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 20; Transkript i 23 prillit, f. 33, rreshtat 3-8.

<sup>61</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 21; Transkript i 23 prillit, f. 33, rreshtat 6-8.

<sup>62</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 13; Transkript i 23 prillit, f. 33, rreshtat 13-16.

## 5. Rregulla107: Materiali i mbrojtur

57. Rregulla 107 e Rregullores, së bashku me nenin 58 të Ligjit, rregullojnë nxjerrjen e materialit që i është dhënë ZPS-së në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja. Një material i tillë, në parim, nuk është objekt i nxjerrjes së informacionit, përveçse me pëlqimin e dhënësit të informacionit.

58. Kur materiali i mbrojtur është objekt i nxjerrjes së informacionit sipas rregullës 102 dhe/ose 103 të Rregullores, ZPS-ja i bën kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* panelit për t'u liruar plotësisht ose pjesërisht nga detyrimi për nxjerrjen e materialit në fjalë ZPS-ja gjithashtu mund të kërkojë masa kompensuese në përputhje me rregullën 108(2) të Rregullores.

59. ZPS-ja parashtron se një pjesë e kufizuar e informacionit sipas rregullës 107 mund të jetë objekt i rregullave 102 dhe/ose 103 të Rregullores për nxjerrjen e informacionit.<sup>63</sup> Ajo po ndërmer hapa aktivë për të marrë përgjigjet e nevojshme nga palët e jashtme për të plotësuar detyrimet për nxjerrjen e materialit sipas Ligjit dhe Rregullores.<sup>64</sup>

60. Duke pasur parasysh se ZPS-ja po kërkon aktivisht leje për material që mund të jetë i rregullës 102(3) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kujton ZPS-së që të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake për çfarëdo problemi në lidhje me lejet e kërkuara.

### C. NXJERRJA E PROVAVE NGA MBROJTJA

61. Parimet dhe procedurat e shpallura në vendimin aktual vlejné njëlloj për Mbrojtjen, në varësi të detyrimeve përkatëse të Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se detyrimet e Mbrojtjes për nxjerrjen e materialit, në përputhje me rregullën 104 të Rregullores, vijnë në fuqi vetëm nëse

---

<sup>63</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 22; Transkript i 23 prillit, f. 34, rreshtat 7-10.

<sup>64</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 22; Transkript i 23 prillit, f. 34, rreshtat 10-17.

Mbrojtja vendos të paraqesë prova dhe, në çdo rast, vetëm pasi ZPS-ja të ketë paraqitur dosjen paraprake dhe listën e dëshmitarëve që do të thirren në gjykim dhe provat materiale të propozuara, në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores.

62. Rrjedhimisht, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe pas paraqitjes prej ZPS-së të dosjes paraprake dhe listës së dëshmitarëve e provave materiale të propozuara, Mbrojtja do të ftohet të paraqesë dosjet paraprake përkatëse ku bën të ditur informacionin e kërkuar në rregullën 95(5) të Rregullores, pa cenuar të drejtën e Mbrojtjes për të njoftuar synimin për t'u mbështetur në alibi, ose arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, në cilëndo datë më të hershme.

63. Duke pasur parasysh se procesi i nxjerrjes së informacionit sapo ka filluar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do të marrë vendime të tjera. Afatet për paraqitjen e dosjes paraprake dhe listën e dëshmitarëve dhe provave materiale të ZPS-së, mbi bazën e të cilave përcaktohen afatet për paraqitjen e dosjes paraprake të Mbrojtjes dhe nxjerrjen e provave, nëse ka, gjithashtu do të përcaktohen në një fazë të mëvonshme.

#### D. PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE PROVAVE

64. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet të sigurohet që provat, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve, të nxirren në gjuhën angleze, gjuha e punës së procesit, siç është përcaktuar me nenin 20 të Ligjit dhe rregullën 8(3) të Rregullores.<sup>65</sup>

65. Në anën tjetër, neni 21(4)(a) i Ligjit përcakton që të akuzuarit duhet të informohen në një gjuhë që e kuptojnë për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tyre, në rastin konkret, në gjuhën shqipe.<sup>66</sup> Sidoqoftë, kjo e drejtë nuk nënkupton të drejtën e

---

<sup>65</sup> Vendimi për Gjuhën e Punës, para. 29(a).

<sup>66</sup> Në këtë kontekst, vihet re se i akuzuari mori fletëarrestimin, urdhrin e transferimit, Aktakuzën e Konfirmuar, dhe tekstet ligjore bazë të DHS në shqip. KSC-BC-2020-04, F00021, Administratorja, *Raport*

pakufizuar dhe absolute për të marrë të gjitha provat, dokumentet dhe parashtrimet e protokolluara në gjuhën e të akuzuarve. Përkthimi i të gjithë dosjes së çështjes, përfshirë provat, do të cenonte të drejtën sipas nenit 21(4)(d) të Ligjit, për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.<sup>67</sup> Rrjedhimisht, duhet të arrihet një ekuilibër midis këtyre të drejtave konkurruese në mënyrë që procesi të jetë njëkohësisht i drejtë dhe i shpejtë.

66. Si rezultat i sa më lart, Rregullorja përcakton se të gjitha deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, do të jenë në dispozicion në gjuhën që kupton dhe flet i akuzuari, siç kërkohet shprehimisht në rregullën 102(1) të Rregullores. Të gjitha provat e tjera paraqiten në gjuhën angleze, në pajtim me vendimin për gjuhën e punës, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ndryshe.

67. Ndihma falas e përkthyesit me gojë së bashku me këshillat profesionale të mbrojtësit, siç parashihet në nenin 21(4)(c) dhe (g) të Ligjit, e ndihmojnë të akuzuarin për të kuptuar provat dhe parashtrimet në lidhje me to që nuk janë në gjuhën shqipe.<sup>68</sup> Mbrojtja mund t'i kërkojë ZPS-së që t'i sigurojë përkthimin e provave specifike ose pjesë të tyre, përveç deklaratave të dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim.<sup>69</sup> Kur bën kërkesa të tilla, Mbrojtja do të tregojë arsyet se përse është thelbësore që këto prova të merren në gjuhën shqipe dhe përse i akuzuari nuk është në gjendje t'i vlerësojë ato me ndihmën e një përkthyesi dhe këshillën e

---

*për Arrestimin dhe Transferimin e Pjetër Shalës në Objektivin e Paraburgimit*, 16 prill 2021, konfidenciale, para 17, 40, 50, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>67</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Ongwen Disclosure Decision](#), para 31-32; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-307, Pre-Trial Chamber III, [Decision on the Defence's Request Related to Language Issues in the Proceedings](#), 4 December 2008, para. 15.

<sup>68</sup> *Shih*, në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-56-Red, Pre-Trial Chamber II, [Public Redacted Version of "Decision on Language Proficiency of Alfred Yekatom for the Purposes of the Proceedings"](#), 11 January 2019, para. 18; [Ongwen Disclosure Decision](#), para. 33.

<sup>69</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Yekatom and Ngaiisona*, ICC-01/04-01/18-163, Pre-Trial Chamber II, [Second Decision on Disclosure and Related Matters](#), 4 April 2019, para. 38; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 23.



mbrojtësit. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Mbrojtjes dhe ZPS-së në këtë aspekt, Mbrojtja duhet t'i drejtohet sa më shpejt që të jetë e mundur Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

#### E. PROCEDURA PËR NXJERRJEN E PROVAVE

68. Materiali shoqërues i parashikuar në rregullën 109(b) dhe (c) të Rregullores përpilohet për t'i mundësuar më së miri palës marrëse që të njihet me materialin e nxjerrë dhe ta shqyrtojë atë, me qëllim që t'i përqendrojë përgatitjet dhe, më përgjithësisht, për të mundësuar një proces më të drejtë dhe më të shpejtë.<sup>70</sup>

69. ZPS-ja parashtron se tabela përmbledhëse e nxjerrjes së materialit sipas rregullës 109(c) të Rregullores duhet të dorëzohet brenda 15 ditësh që nga paraqitja e çdo dosjeje paraprake.<sup>71</sup> Në lidhje me nënkategorizimin specifik për çështjen në sistemin elektronik *Legal Workflow* për materialet sipas rregullës 102(1)(a) dhe (b) dhe 104(1), (5), dhe (6) të Rregullores, ZPS-ja parashtron se lloji i provave që do të paraqiten është i tillë që shumë materiale individuale të provave do të kenë lidhje me të gjitha veprat penale dhe format e përgjegjësisë duke e bërë kategorizimin me dobi të kufizuar, veçanërisht duke mbajtur parasysh burimet e nevojshme për zbatimin e tyre.<sup>72</sup>

70. Mbrojtja parashtron se tabela përmbledhëse e nxjerrjes së materialit duhet të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast shumë kohë përpara se Prokuroria të paraqesë dosjen paraprake.<sup>73</sup> Mbrojtja gjithashtu mbështet miratimin e

---

<sup>70</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-47, Pre-Trial Chamber II, [Decision Setting the Regime for Evidence Disclosure and Other Related Matters](#), 12 prill 2013, para 31-32; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-55, Pre-Trial Chamber III, [Decision on the Evidence Disclosure System and Setting a Timetable for Disclosure between the Parties](#), 31 July 2008, para 72-72.

<sup>71</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 29.

<sup>72</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para 26-27; Transkript i 23 prillit, f. 35, rreshti 24 deri në f. 37, rreshti 5, f. 38, rreshtat 14-18.

<sup>73</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 9.

nënkategorizimit specifik për çështjen gjyqësore në sistemin elektronik *Legal Workflow* dhe propozon dy nënkategori: “elementet kontekstuale: informacion bazë” dhe “vendndodhja: tjetër”.<sup>74</sup> Mbrojtja parashtrohet se nënkategoritë mund të marrin më shumë rëndësi nëse ka akuza shtesë ose bashkim çështjesh.<sup>75</sup>

71. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se rregulla 109(c) e Rregullores përshkruan përgjithësisht kategoritë standarde të mundshme të materialit provues kur ngarkohet në sistemin elektronik *Legal Workflow* dhe i bëhet i njohur palës marrëse: elementet kontekstuale të krimeve, krimet bazë, sjellja e pretenduar e të akuzuarit dhe atje ku është e zbatueshme, provat që do të prezantohen nga ZPS-ja (“kategoritë standarde”). Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon gjithsesi se specifikimi dhe nënkategorizimi i mëtejshëm është i nevojshëm që të garantojë mbarëvajtjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit. Ky përfundim bazohet veçanërisht në parashtrimet e Mbrojtjes për këtë pikë, disponueshmërinë e përditësimit të kohëve të fundit të sistemit elektronik *Legal Workflow* që lehtëson prezantimin e organizuar të provave, dhe në faktin se pas ZPS-së, provat që do të nxirren sipas rregullës 102(1)(a) dhe (b) të Rregullores janë mjaft të kufizuara. Për pasojë, ky kategorizim specifik për çështjen zbatohet në sistemin elektronik në *Legal Workflow* dhe vetëm në lidhje me materialin sipas rregullave 102(1)(a) dhe (b) dhe 104(1), (5) dhe (6) të Rregullores. Si pasojë, krahas kategorive standarde, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton kategorizimet e mëposhtme specifike për çështjen gjyqësore në sistemin elektronik *Legal Workflow*: (i) elemente kontekstuale: “krime lufte”; (ii) krime bazë: “pika 1”, “pika 2”, “pika 3”, “pika 4”, “të gjitha”; (iii) vendndodhja: “Kukës”; (iv) sjellja e pretenduar e të akuzuarit: “kryerje e drejtpërdrejtë”, “NKPI”, “NKPII”, “NKPIII”, “ndihmë dhe inkurajim”, “të gjitha”; dhe (v) i akuzuari: “Pjetër Shala”.

---

<sup>74</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para 7-8; Transkripti i 23 prillit, f. 37, rreshti 23 deri te f. 38, rreshti 9.

72. Në këtë moment Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i miraton kategoritë shtesë të propozuara nga Mbrojtja. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se në këto rrethana është më e udhës që nënkategoritë t'u përshtaten akuzave aktuale të cilat përfshijnë vetëm një vendndodhje (Kukës). Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ekziston tashmë një kategori elementesh kontekstuale dhe se informacioni bazë nuk është pjesë e elementeve ligjore të akuzave.<sup>76</sup>

73. Për sa i takon tabelës sipas rregullës 109(c), Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të miratojë tabelën e propozuar në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, e cila përfshin kategoritë standarde.<sup>77</sup> Duke qenë se përmbledhja e detajuar jep një analizë të gjerë të materialit sipas rregullës 102(1)(a), tabela sipas rregullës 109(c) ka lidhje me materialin sipas rregullës 102(1)(b) dhe rregullën 102(2) për ZPS-në dhe materialin sipas rregullës 104(1), (5), dhe (6) për Mbrojtjen.<sup>78</sup>

74. Në mënyrë që të mos çrregullohet ecuria e nxjerrjes së informacionit dhe duke mbajtur parasysh efikasitetin në përpilimin e tabelës së propozuar rreth afatit të dorëzimit të dosjes paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se mënyra më e shpejtë e procedimit në çështjen aktuale është që tabela e propozuar t'i jepet palës kundërshtarë në kohën e dorëzimit të cilësdo dosjeje paraprake. Për këtë arsye palët do të dorëzojnë një tabelë sipas rregullës 109(c) brenda shtatë ditësh që nga dita e dorëzimit të dosjes paraprake përkatëse.

---

<sup>76</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-2205 (OA15 OA16), Appeals Chamber, *Judgment on the Appeals of Mr Lubanga Dyilo and the Prosecutor Against the Decision of Trial Chamber I of 14 July 2009 entitled "Decision giving notice to the parties and participants that the legal characterisation of facts may be subject to change in accordance with Regulation 55(2) of the Regulations of the Court"*, 8 December 2009, poshtëshënimi 163.

<sup>77</sup> KSC-BC-2020-07, F00109/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimeve në lidhje me kategorizimet sipas rregullës 109(c)*, 1 shkurt 2021, publik.

<sup>78</sup> Në mënyrë të ngjashme, KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Përkatëse*, 9 tetor 2020, publik, para. 71; KSC-BC-2020-07, F00121, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Parashtrimet në lidhje me Kategorizimin sipas Rregullës 109(c)*, 11 shkurt 2021, publik, para 15-19; KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të Lidhura me Të*, 12 mars 2021, publik, para 9-10, 25.

## F. KUFIZIMET PËR NXJERRJEN E INFORMACIONIT

### 1. Parimet e përgjithshme

75. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se nxjerrja e plotë e të gjitha materialeve dhe provave relevante është rregulli, ndërsa mosnxjerrja e informacionit është përjashtim.<sup>79</sup> Siç sugjeron leximi i kombinuar i nenit 21(6) të Ligjit dhe rregullave 80(1) dhe 108(1) të Rregullores, çfarëdo kufizimi i nxjerrjes së plotë të informacionit duhet të jetë rreptësisht i domosdoshëm për mbrojtjen e: (i) sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët në DHS, me kusht që këto masa të përputhen me të drejtat e të akuzuarve; (ii) hetimet aktuale ose të ardhshme; dhe (iii) interesin publik dhe të drejtat e palëve të treta. Në këtë kontekst, kujtojmë se është e lejueshme mosnxjerrja për Mbrojtjen, e një informacioni të caktuar para gjykimit.<sup>80</sup>

76. Redaktimet që synojnë mbrojtjen e hetimeve aktuale ose të ardhshme ose të interesit publik dhe të drejtave të palëve të treta zbatohen vetëm me kërkesë të Prokurorit të Specializuar ose të Mbrojtjes, të paraqitura konfidencialisht dhe *ex parte*.<sup>81</sup> Redaktimet që synojnë mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të

---

<sup>79</sup> *Shih gjithashtu, ICC, Prosecutor v. Lubanga, ICC-01/04-01/06-568 (OA3), Appeals Chamber, [Judgment on the Prosecutor's appeal against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "Decision Establishing General Principles Governing Applications to Restrict Disclosure pursuant to Rule 81 \(2\) and \(4\) of the Rules of Procedure and Evidence"](#) ("13 October 2006 Judgment"), 13 tetor 2006, para 1, 39; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo, ICC-01/04-01/07-475 (OA), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of the Prosecutor against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements"](#) ("13 May 2008 Judgment"), 13 May 2008, para. 70.**

<sup>80</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [13 May 2008 Judgment](#), para. 68.

<sup>81</sup> Rregulla 108(1) dhe (6) e Rregullores.

dhëna nga dëshmitarët, zbatohen me kërkesë të cilësdo prej palëve, të paraqitura konfidencialisht dhe *ex parte* ose *proprio motu*.<sup>82</sup>

77. Së fundi, nevoja për redaktime duhet të vlerësohet rast pas rasti.<sup>83</sup> Në përcaktimin e sistemit të redaktimit që do të zbatohet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të bëjë balancimin midis interesave konkurruese, ndërsa siguron që procesi të jetë i drejtë dhe i shpejtë.

## 2. Kriteret ligjore

78. Gjatë vlerësimit nëse një informacion i caktuar mund të mos i jepet palës marrëse, duhet të përcaktohet nëse:<sup>84</sup>

- (i) nxjerrja e informacionit në fjalë për palën marrëse, në ndryshim nga nxjerrja për publikun, paraqet rrezik objektivisht të arsyetueshëm për personin ose interesin e mbrojtur;
- (ii) masa mbrojtëse është rreptësisht e domosdoshme.<sup>85</sup> Si rrjedhojë, nëse janë të mjaftueshme dhe të realizueshme masa mbrojtëse më pak kufizuese, duhet të zgjidhen masa mbrojtëse të tilla; dhe
- (iii) masa mbrojtëse është proporcionale kundrejt cenimit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjykimit të drejtë.<sup>86</sup>

<sup>82</sup> Rregulla 80(1) dhe (3) e Rregullores.

<sup>83</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [13 October 2006 Judgment](#), para. 36; [13 May 2008 Judgment](#), para 2, 59, 66.

<sup>84</sup> KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To* ("Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Mustafa"), 9 tetor 2020, publik, para. 76. Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-773 (OA5), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr. Thomas Lubanga Dyilo against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Requests and Amended requests for Redactions under Rule 81"](#), 14 dhjetor 2006, para 21, 33-34; [13 May 2008 Judgment](#), para 95-99; ECtHR, *Rowe and Davis v. United Kingdom*, no. 2890/95, [Judgment](#), 16 February 2000, para. 61; *Botmeh and Alami v. United Kingdom*, no. 15187/03, [Judgment](#), 7 June 2007, para. 37.

<sup>85</sup> Neni 21(6) i Ligjit.

<sup>86</sup> Rregulla 80(1) e Rregullores.

### 3. Sistemi i redaktimit

79. ZPS-ja dhe Mbrojtja mbështesin miratimin e sistemit të redaktimit të çështjes *Gucati dhe Haradinaj*.<sup>87</sup>

80. Për shpejtimin e procesit dhe krijimit të një sistemi efikas, të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm për redaktime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se është e përshtatshme të miratojë sistemin e mëposhtëm të redaktimit. Me miratimin e këtij sistemi në çështjen në fjalë, palët kanë udhëzime të mjaftueshme për zbatimin e redaktimeve, nëse do të ketë, para nxjerrjes së provave që posedojnë.

81. Sipas këtij sistemi, provat mund të nxirren nga cilado palë me redaktime të bëra drejtpërdrejt për kategori të paracaktuara të informacionit (“redaktime standarde”) pa autorizim gjyqësor paraprak. Në këtë rast, pala që bën nxjerrjen e informacionit nuk është e detyruar që të paraqesë kërkesë të veçantë. Pala marrëse ka të drejtë të kundërshtojë cilindo redaktim të zbatuar pas nxjerrjes së provave.<sup>88</sup>

82. Për redaktimet që janë jashtë kategorive të paracaktuara të përmendura më lart (“redaktimet jostandarde”), pala që nxjerr informacionin duhet t’i paraqesë kërkesë të veçantë Gjykatësit të Procedurës Paraprake për autorizim për të kufizuar nxjerrjen e informacionit, sipas procedurës së përcaktuar më poshtë.<sup>89</sup>

83. Në rastin e të dy llojeve të redaktimeve, standarde dhe jostandarde, informacioni që nuk nxirret mund të nxihet, censurohet, ose të zëvendësohet me tekstin “[REDAKTUAR]”. Gjithashtu, pala që bën nxjerrjen e informacionit, bën të ditur llojin e redaktimit në kutinë e redaktimit ose në çfarëdo vendi të përshtatshëm duke përdorur kod specifik si në listën më poshtë, përveçse kur një shënim i tillë do të binte

---

<sup>87</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 30; Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 10; Transkript i 23 prillit, f. 39, rreshtat 2-16.

<sup>88</sup> *Shih më poshtë* para. 85.

<sup>89</sup> *Shih më poshtë* para. 90.

ndesh me qëllimin e redaktimit. Ky format do ta lejojë lexuesin që ta njohë menjëherë llojin e informacionit që është redaktuar ose hequr dhe arsyetimin përkatës. Në rast se informacioni i redaktuar i takon më shumë se një kategori, duhet të shënohen të gjitha kodet përkatëse.

84. Kur nxirret informacioni me redaktime, pala që bën nxjerrjen e informacionit i cakton pseudonim të veçantë çdo personi identiteti i të cilit është redaktuar sipas kategorive A.3 dhe A.4, siç është përcaktuar më poshtë, që shoqërojnë kodet përkatëse të redaktimit. Qëllimi i pseudonimeve të tilla është që t'i mundësojë lexuesit të materialit të redaktuar të identifikojë nëse është fjala për të njëjtin person që është përmendur në disa prova materiale. Pala që bën nxjerrjen e materialit nuk ka nevojë të japë kodin e kategorisë dhe/ose pseudonimin kur kjo bie ndesh me qëllimin e redaktimit, por bën të qartë se cilat kode/pseudonime janë hequr për këtë arsye.

85. Pala marrëse mund të kundërshtojë çfarëdo redaktimi konkret për të cilin mendon se është i papërligjur, ose nëse mendon se një redaktim konkret duhet të hiqet si rezultat i rrethanave të ndryshuara. Për këtë qëllim ajo i drejtohet drejtpërdrejt palës që bën nxjerrjen e informacionit. Palët konsultohen në mirëbesim për të sqaruar çështjen. Nëse palët nuk janë në gjendje të pajtohen, pala marrëse mund t'i bëjë kërkesë pa vonesë të panevojshme Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të vendosë, duke krijuar kështu detyrim për palën që nxjerr informacionin, për të arsyetuar redaktimin në fjalë. Në këtë rast, pala që bën nxjerrjen e informacionit e dorëzon përgjigjen e saj në dokumentacionin e çështjes brenda pesë ditësh pas kundërshtimit, përveçse kur vendoset ndryshe nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

86. Pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet të monitorojë nevojën e vazhdueshme për redaktime dhe rinxjerr prova me më pak redaktime pa kërkuar paraprakisht leje nga paneli përkatës menjëherë pasi arsyet që justifikojnë redaktimet nuk ekzistojnë më, ose, nëse është e zbatueshme, bën kërkesë sipas rregullës 81(1) dhe (2) të Rregullores. Redaktimet mund të hiqen edhe pas: (i) marrëveshjes midis palëve se nuk

ekziston më rrezik objektivisht i identifikueshëm për personin ose interesin në fjalë; ose (ii) urdhrit nga paneli kompetent. Nëse informacioni i redaktuar i takon më shumë se një kategori, redaktimet duhet të hiqen pas përfundimit të të gjitha afateve përkatëse. Nëse pala që nxjerr informacionin dëshiron t'i mbajë redaktimet edhe pas kalimit të afatit për heqjen e tyre, ajo duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

87. Për të verifikuar në bazë të kompetencës së tij diskrecionale, vlefshmërinë e çfarëdo redaktimi të zbatuar nga pala që bën nxjerrjen e informacionit dhe, nëse është e nevojshme, për të urdhëruar palën që bën nxjerrjen e informacionit *proprio motu* të heqë, pjesërisht ose plotësisht, çfarëdo redaktimi, pasi t'i ketë dhënë mundësi palës që bën nxjerrjen e informacionit që të paraqesë vërejtjet e veta, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se është e përshtatshme që të marrë provat në versionin e paredaktuar në kohën që palës marrëse i jepet versioni i redaktuar i tyre.<sup>90</sup> Kjo i mundëson Gjykatësit të Procedurës Paraprake që, në përputhje me rregullat 80(1) dhe 108(1) të Rregullores, të verifikojë shkallën dhe vlefshmërinë e çfarëdo redaktimi, duke shtuar kështu edhe një nivel të rishikimit në të mirë të palës marrëse. Kjo i mundëson Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të reagojë shpejt nëse ka kundërshtime në lidhje me redaktimet e zbatuara, sipas rastit. Kjo nuk e paragjykon faktin që pala që bën nxjerrjen e informacionit mund të mbështetet vetëm në formën e redaktuar të provave, siç i janë dhënë palës marrëse.

#### 4. Redaktimet standarde

88. Kategoritë për redaktime standarde janë përvijuar qartë dhe të rrënjosura në praktikat e gjykatave të tjera<sup>91</sup> dhe janë miratuar në çështje të tjera para DHS-së.<sup>92</sup>

---

<sup>90</sup> Vetëm Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të ketë qasje në dokumentin e mëparshëm në sistemin e administrimit elektronik. Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 32; [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 28.

<sup>91</sup> Për shembull, ICC, [Yekatom Disclosure Decision](#), paras 25-26; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 29.

<sup>92</sup> Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Mustafa*, para. 86; KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To* ("Vendimi mbi



Gjykatësi i Procedurës Paraprake këtu miraton kategoritë e mëposhtme të redaktimeve standarde dhe arsyetimet e tyre duke pasur parasysh standardin e shtjelluar më lart.<sup>93</sup> Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, nxjerrja e informacionit e kategorizuar më poshtë për palën marrëse rregullisht nënkupton rrezik objektivisht të identifikueshëm për interesat në fjalë dhe kërkon miratimin e masave mbrojtëse që janë absolutisht të domosdoshme, gjithmonë duke mbajtur parasysh të drejtat e të akuzuarve dhe drejtësinë e gjykimit.

89. Kategoritë e informacionit që mund të redaktohen nga pala që bën nxjerrjen e informacionit pa autorizim gjyqësor paraprak janë:

(a) *Redaktimet sipas rregullës 108(1)(a) të Rregullores:*

**Kategoria "A.1":** Vendndodhjet e intervistave dhe të akomodimit, nëse nxjerrja e informacionit në lidhje me to mund të tërheqë vëmendjen në mënyrë të papërshtatshme ndaj lëvizjeve të palëve, personelit, viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të Dhomave të Specializuara, duke krijuar në këtë mënyrë rrezik objektiv për hetime aktuale apo hetime të ardhshme. Në parim, informacioni nuk është i rëndësishëm për palën tjetër. Redaktime të tilla hiqen kur vendi nuk përdoret më në hetimet aktuale dhe të ardhshme.

**Kategoria "A.2":** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të personelit ose kontraktuesve të palëve, Zyrës Administrative ose Dhomave të Specializuara (duke përjashtuar hetuesit), të cilët udhëtojnë shpesh në terren ose janë të vendosur atje, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikonte këta persona dhe/ose të pengonte punën e tyre, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale dhe të ardhshme (saktësohet më tej në "A.2.1." për përkthyesit me shkrim dhe gojë, "A.2.2." për stenografët, "A.2.3" për ekspertët psiko-socialë, "A.2.4" për ekspertët e tjerë mjekësorë, "A.2.5." për pjesëtarët e tjerë të personelit që hyjnë në këtë kategori, dhe "A.2.6." për kontraktuesit e tjerë që hyjnë në këtë kategori).

**Kategoria "A.3":** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të hetuesve, duke mbajtur parasysh se palët kanë një numër të kufizuar hetuesish, nxjerrja e këtij informacioni mund t'i rrezikojë ata dhe pengojë punën e tyre në terren, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale ose të ardhshme, ose rrezikon sigurinë e dëshmitarëve ose personave të tjerë që ata intervistojnë ose kontaktojnë. Në pajtim

---

Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Thaçi dhe të tjerë*"), 23 nëntor 2020, publik, para. 95; KSC-BC-2020-07, F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To* ("Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*"), 22 janar 2020, publik, para. 82.

<sup>93</sup> *Shih më lart* para. 78.

me paragrafin 84 më lart, pala që bën nxjerrjen e informacionit e shënon pseudonimin unik të hetuesit, si dhe kodin e kategorisë (p.sh. “A.3.1.”, “A.3.2.”, “A.3.3.”, etj).

**Kategoria “A.4”:** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të ndërmjetësuesve, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund t’i rrezikojë këta persona dhe të pengojë punën e tyre në terren, duke rrezikuar kështu hetimet aktuale ose të ardhshme, ose rrezikon sigurinë e dëshmitarëve ose personave me të cilët ata kanë kontakt. Në pajtim me paragrafin 84 më lart, pala që bën nxjerrjen e informacionit e shënon pseudonimin unik të ndërmjetësuesit, si dhe kodin e kategorisë (p.sh. “A.4.1.”, “A.4.2.”, “A.4.3.”, etj).

**Kategoria “A.5”:** Të dhënat e identifikuese dhe të kontaktit të sinjalizuesve dhe burimeve, përfshirë dëshmitarët e mundshëm,<sup>94</sup> nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të çojë në frikësimin e dëshmitarëve ose në ndërhyrjet te ta, gjë që mund të dëmtojë hetimet aktuale ose të ardhshme (saktësohet më tej si “A.5.1.” për sinjalizuesit dhe burimet individuale, përfshirë dëshmitarët e mundshëm, “A.5.2.” për organizatat joqeveritare, “A.5.3.” për organizatat ndërkombëtare, “A.5.4.” për agjencitë shtetërore, “A.5.5.” për institucionet akademike, “A.5.6.” për kompanitë private”, dhe “A.5.7.” për burimet e tjera). Kur sinjalizuesi ose burimi jep material që nxirret, identiteti i tyre duhet të nxirret si burim në kontekst të asaj nxjerrjeje të informacionit, me kusht që të mos ketë probleme shtesë në lidhje me sigurinë dhe sinjalizuesi ose burimi nuk është i mbrojtur sipas nenit 35(2)(e) të Ligjit dhe rregullës 107 të Rregullores.

**Kategoria “A.6”:** Mjetet e përdorura për komunikim me dëshmitarët, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të komprometojë teknikat hetimore dhe vendndodhjen e dëshmitarëve. Në parim, ky informacion nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

**Kategoria “A.7”:** Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(a) të Rregullores, nëse nxjerrja e informacionit të redaktuar do të dëmtonte hetimet aktuale, ose të ardhshme.

---

<sup>94</sup> Dëshmitarë të mundshëm janë ata që janë marrë ose do të merren në pyetje nga palët. Për klasifikimin si “burime të prokurorisë”, shih ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-476 (OA2), Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Germain Katanga against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled “First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements”](#), 14 maj 2008, para 1-2, 46, 49. Dëshmitarët e mundshëm dallojnë nga “palët e treta të pafajshme” (shih kategorinë B.3 më poshtë): ndërsa të parët janë kontaktuar ose do të kontaktohen nga palët gjatë hetimeve përkatëse në kontekst të proceseve gjyqësore të DHS-së, palët e treta të pafajshme nuk kontaktohen në kontekst të hetimeve të palëve dhe mund të mos jenë të vetëdijshëm se emri i tyre është përmendur në kontekst të hetimeve të tilla. Ky dallim mund të jetë me rëndësi për palën marrëse dhe duhet të shënohet duke përdorur kode të ndryshme.

(b) Redaktimet sipas nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullave 80(4)(a)(i)-(ii) dhe 108(1)(b)-(c)

të Rregullores:

**Kategoria “B.1”:** Të dhënat e kontaktit të dëshmitarëve, përfshirë numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat dhe postën elektronike (email), nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e personit në fjalë.

**Kategoria “B.2”:** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të anëtarëve të familjeve të dëshmitarëve, si numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat dhe posta elektronike, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e tyre. Individë të tillë janë jashtëzakonisht të rrezikuar duke pasur parasysh se ata nuk janë pajtuar që të jenë pjesë e proceseve të Dhomave të Specializuara dhe mund të mos jenë në dijeni se një anëtar i familjes është dëshmitar dhe, për këto arsye, ekziston rreziku se mund të konsiderohen sikur kanë lidhje me Dhomat e Specializuara. Redaktimet e të dhënave të kontaktit duhet të jenë në vijimësi. Kur redaktimi i të dhënave identifikuese zbatohet vetëm për të mbrojtur dëshmitarin për të cilin redaktimet nuk janë më të justifikueshme, redaktimi nën këtë kategori duhet të hiqet kur të nxirret identiteti i dëshmitarit. Kur redaktimi i të dhënave identifikuese nën këtë kategori zbatohet për sigurinë e një anëtari të familjes dhe identiteti i këtij anëtari të familjes nuk është i rëndësishëm për asnjë aspekt të njohur në këtë çështje, redaktimet e kësaj kategorie duhet të jenë në vijimësi. Për redaktimet që nuk hyjnë në rastet e lartpërmendura, pala që nxjerr informacionin duhet t’i bëjë kërkesë panelit përkatës.

**Kategoria “B.3”:** Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të individëve që janë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dëshmitarëve, por të cilët nuk janë viktimat, dëshmitarë aktualë ose të mundshëm, burime ose anëtarët e familjeve të tyre (“palët e treta të pafajshme”),<sup>95</sup> përfshirë numrat e telefonit, vendndodhjet/adresat, postën elektronike dhe fotografitë, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të paraqesë rrezik për sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e tyre. Individë të tillë nuk janë pajtuar të jenë pjesë e proceseve të Dhomave të Specializuara dhe mund të mos jenë në dijeni që emri i tyre përmendet në kontekst të këtyre proceseve dhe, për këtë arsye, janë në rrezik të shihen si dëshmitarë ose bashkëpunëtorë të mundshëm me Dhomat e Specializuara. Redaktimet e të dhënave të kontaktit nën këtë kategori duhet të jenë në vijimësi. Për individët që nuk janë relevant për asnjë nga problemet e njohura në këtë çështje, redaktimet e të dhënave identifikuese nën këtë kategori duhet të jenë në vijimësi. Përndryshe, pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet t’i bëjë kërkesë panelit përkatës.

**Kategoria “B.4”:** Vendndodhja e dëshmitarëve të pranuar në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dhënat e vendeve që përdoren për zhvendosjen e këtyre dëshmitarëve aktualisht dhe në të ardhmen, përfshirë ato që përdoren

<sup>95</sup> Rregulla 80(1) e Rregullores. Në mënyrë të ngjashme, ICC, [13 May 2008 Judgment](#), para 1, 40, 56.

para hyrjes në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, nëse nxjerrja e këtij informacioni mund të komprometojë konfidencialitetin e këtyre vendeve, duke i rrezikuar kështu dëshmitarët e mbrojtur. Në parim, informacioni nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

**Kategoria "B.5":** Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(b)-(c) të Rregullores, nëse nxjerrja e informacionit të redaktuar do të shkaktonte rrezik të rëndë për sigurinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese ose anëtarëve të familjeve ose do të ishte në kundërshtim me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta për çfarëdo arsye.

(c) *Informacion tjetër që nuk është objekt i nxjerrjes së informacionit në pajtim me Rregulloren:*

**Kategoria "C":** Produkti i punës së brendshme që përmban cilido material që është objekt i nxjerrjes së informacionit në përputhje me rregullën 106 të Rregullores. Për redaktime të tilla nuk nevojitet miratimi i panelit.

**Kategoria "D":** Komunikimet e bëra në kontekst të marrëdhënieve profesionale midis një personi dhe mbrojtësit të specializuar të tij në përputhje me rregullën 111(1) të Rregullores. Për redaktime të tilla nuk nevojitet miratimi i panelit. Këto redaktime nuk mund të zbatohen për informacionin sipas rregullës 111(2)-(6) të Rregullores. Në këto raste, duhet t'i bëhet kërkesë panelit përkatës.

**Kategoria "F":** Redaktimet e autorizuara në procese të mëhershme sipas rregullës 81(1)(a) të Rregullores. Redaktime të tilla duhet të përmbajnë numrin e çështjes dhe të vendimit përkatës.

Redaktimet e kategorive A-D duhet të zbatohen, në përputhje me rregullat 106 dhe 108(1) të Rregullores, *mutatis mutandis*, për informacionin të barasvlershëm nga agjenci të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, përfshirë policinë dhe prokurorinë e Kosovës, TPNJ-në, KFOR-in, UNMIK-un dhe EULEX-Kosova.<sup>96</sup> Kur përdoren redaktime të tilla, duhet të përfshihet shenja identifikuese e agjencisë në fjalë së bashku me kodin përkatës të redaktimit.

## 5. Redaktimet jostandarde

90. Redaktimet jostandarde kanë të bëjnë veçanërisht me emrat e dëshmitarëve identitetet e të cilëve nuk duhen t'i bëhen të njohura palës kundërshtare para fillimit

---

<sup>96</sup> Neni 37(1) i Ligjit.

të gjykimit dhe në rastet kur nuk duhet të nxirren pjesë të tëra të provave.<sup>97</sup> Në raste të tilla, pala që bën nxjerrjen e informacionit i paraqet paraprakisht në kohë të mjaftueshme kërkesë panelit përkatës për të mundësuar nxjerrjen në kohë të vendimit përkatës dhe më pas nxjerrjen e provave brenda afateve të parapara në Rregullore ose në vendimin e panelit. Në të njëjtën kohë, versioni i redaktuar i kërkesës duhet t'i jepet palës marrëse; pala marrëse mund të përgjigjet brenda pesë ditësh që nga njoftimi i kërkesës. Për më tepër, për t'i mundësuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të nxjerrë vendim objektiv, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") paraqet, brenda pesë ditësh pas njoftimit të kërkesës për mosnxjerrje të informacionit, vlerësim të rrezikut për secilin dëshmitar në lidhje me të cilin është kërkuar mosnxjerrja e identitetit, ose nëse është i nevojshëm informacionin e përditësuar për dëshmitarin për të cilin është paraqitur vlerësimi i rrezikut. Për të shmangur nxjerrjen e informacionit të njëjtë disa herë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se nuk është e nevojshme që pala që bën nxjerrjen e informacionit, të nxjerrë materialin përkatës në të njëjtën kohë me kërkesën për redaktim jostandarde. Me autorizim, të gjitha redaktimet jostandarde shënohen si **kategoria "E"**.

91. Redaktimet që hyjnë në këtë kategori hiqen pas urdhrit të panelit përkatës ose sapo arsyet për ligjëse nuk ekzistojnë më. Nëse njëra nga palët synon heqjen e një redaktimi jostandard që ka të bëjë me emrin e dëshmitarit sepse beson se arsyet që justifikojnë mosnxjerrjen e identitetit nuk ekzistojnë më, ajo palë e njofton Gjykatësin e Procedurës Paraprake dhe ZMMD-në për këtë pesë ditë para heqjes së redaktimit në fjalë.

---

<sup>97</sup> Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Mustafa*, para. 88; <sup>97</sup> Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Thaçi dhe të tjerë*, para. 97; <sup>97</sup> Vendimi mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 83. Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-224, Pre-Trial Chamber II, [Decision on issues related to disclosure and exceptions thereto](#), 23 prill 2015, para. 7; [Yekatom Disclosure Decision](#), para. 32; [Al Hassan Disclosure Decision](#), para. 33.

## V. VENDIM

92. Për arsyet e mësipërme Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** palët dhe Administratoren që të zbatojnë parimet për nxjerrjen e provave, të shtjelluara në paragrafët 28-37 të këtij vendimi;
- b. **URDHËRON** ZPS-në që të përfundojë nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(a) të Rregullores, së bashku me përmbledhjen e detajuar (në formën konfidenciale (të redaktuar) dhe publike (të redaktuar), brenda **të mërkurës, 19 maj 2021**;
- c. **URDHËRON** ZPS-në që të përfundojë nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, brenda **të premtes 30 korrik 2021**, dhe të paraqesë kërkesat për masa mbrojtëse në lidhje me këtë material jo më vonë se **të premten, 11 qershor 2021**;
- d. **URDHËRON** ZPS-në që t'i japë Mbrojtjes njoftim të hollësishëm të provave të rregullës 102(3) të Rregullores brenda **të premtes, 3 shtator 2021**;
- e. **URDHËRON** Mbrojtjen që t'i bëjë me dije ZPS-së, brenda **të premtes, 17 shtator 2021**, ose në çdo kohë më herët, se në cilët prova të rregullës 102(3) të Rregullores, kërkon të ketë qasje me anë të nxjerrjes ose këqyrjes së informacionit;
- f. **URDHËRON** ZPS-në, që në bazë të kërkesës së Mbrojtjes sipas pikës (e) më lart, të nxjerrë ose t'i japë Mbrojtjes qasje në materialin e përzgjedhur që nuk ka nevojë për redaktime, jo më vonë se **të premten 24 shtator 2021, ose brenda një jave që nga kërkesa Mbrojtjes**, cilado të jetë data më e hershme;
- g. **URDHËRON** ZPS-në, që në bazë të njoftimit të Mbrojtjes sipas pikës (e) më lart, të paraqesë kërkesat për masa mbrojtëse për materialin e zgjedhur jo

më vonë se të premten 1 tetor 2021, ose brenda dy javësh që nga njoftimi i Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme;

- h. **URDHËRON** ZPS-në t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake brenda pesë ditësh nga kërkesa e Mbrojtjes, sipas pikës (e) më lart, nëse e kundërshton rëndësinë materiale të provave;
- i. **URDHËRON** ZPS-në të nxjerrë paketën/paketat e mbetura të materialit sipas rregullës 103 menjëherë dhe në vijimësi;
- j. **URDHËRON** ZPS-në, që, nëse ndonjë material i rregullës 103 të Rregullores ka nevojë për redaktime, të bëjë kërkesë për masa mbrojtëse sa më parë dhe të nxjerrë menjëherë këtë material me redaktime, nëse miratohet;
- k. **URDHËRON** ZPS-në që sa më shpejt ta njoftojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake për çfarëdo problemi në lidhje me materialin që ndikohet nga rregulla 107 e Rregullores;
- l. **URDHËRON** palët që të zbatojnë kriteret e sistemit të redaktimit të përcaktuara në paragrafët 75-91 të këtij vendimi;
- m. **URDHËRON** palët që të përdorin kategoritë standarde dhe nënkategoritë specifike sipas çështjes në fushën e meta të dhënave për çdo material të nxjerrë, siç tregohet në paragrafin 71, më lart;
- n. **URDHËRON** palët të dorëzojnë tabelat përkatëse sipas rregullës 109(c), siç parashikohet në paragrafët 73-74, më lart, brenda një jave, nga paraqitja e dosjeve paraprake përkatëse; dhe
- o. **URDHËRON** ZMMD-në të paraqesë, brenda pesë ditësh nga paraqitja e kërkesës nga secila palë për mosnxjerrjen e informacionit, vlerësim të rrezikut për secilin dëshmitar për të cilin është kërkuar mosnxjerrja e identitetit, siç është përcaktuar në paragrafin 90 të këtij vendimi.

/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premte, 30 prill 2021  
Hagë, Holandë.